

**UNIVERSITETI MJEKËSISË TIRANË**  
**FAKULTETI I SHKENCAVE MJEKËSORE TEKNIKE**  
**DEPARTAMENTI I LËNDËVE PARAKLINIKE**

**LUMBAGO- KORRELACIONE KLINIKE DHE**  
**IMAZHERIKE**

**Disertacion**  
**Për Marrjen e Gradës Shkencore**

**DOKTOR**

**Disertanti: Leonard MOLLA**  
**Udhëheqës Shkencor: Prof. Asc. Dr. Ilirjana ZEKJA**

**TIRANË 2022**

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**UNIVERSITETI I MJEKËSISË TIRANË**  
**FAKULTETI I SHKENCAVE MJEKËSORE TEKNIKE**



**UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË**

## **DISERTACION**

*I PARAQITUR NGA*

**Z. Leonard MOLLA**

**PËR MARRJEN E GRADËS SHKENCORE**

## **DOKTOR**

**TEMA: “LUMBAGO- KORRELACIONE KLINIKE DHE IMAZHERIKE”**

**MBROHET NË DATË: ...../..... PARA JURISË:**

1. ....KRYETAR
2. ....ANËTAR (OPONENT)
3. ....ANËTAR (OPONENT)
4. ....ANËTAR
5. ....ANËTAR

***Parathënie***

*Dhimbja e mesit (lumbago) është ankesa më e zakonshme muskuloskeletike që prek popullatën adulte, me një prevalencë deri në 84% dhe përfaqëson një problem të madh social dhe ekonomik.*

*Incidenca e saj është gjithnjë e në rritje dhe barra e saj ekonomike përfaqësohet drejtpërdrejt nga kostot e larta të shpenzimeve të kujdesit shëndetësor dhe indirekt nga ulja e produktivitetit. Këto kosto priten të rriten edhe më shumë në vitet e ardhshme.*

*Për këtë arsye diagnostikimi i saktë dhe trajtimi adekuat janë shumë të rëndësishëm.*

## **Falenderim**

Falenderoj udhëheqësin shkencor Prof. Asc. Dr. Ilirjana ZEKJA për ndihmën në të gjitha etapat e studimit duke më ofruar eksperiencën e saj.

Falenderoj familjen time për mbështetjen dhe kurajon për të përfunduar me sukses këtë projekt shkencor.

**Shkurtesa**

BMI	Body mass index
LBP	Low Back Pain
IVD	Disqet Intervertebrale
MRI	Rezonanca Magnetike
CT	Computed Tomography
SIJ	Artikulacioni Sakroiliak
DD	Degjenerim i Diskut
CI	Confidence Interval
OR	Odds Ratio

## **Përmbajtja**

<i>PARATHËNIE</i> .....	III
SHKURTESA .....	V
ABSTRAKT .....	IX
I HYRJE.....	X
1.1 Përkufizimet e dhimbjes së shpinës .....	xi
1.2 Historia e dhimbjes lumbare .....	xi
1.3 Tendencat laike në dhimbjen e shpinës .....	xii
2.0 Epidemiologjia e lumbagos.....	xiii
2.1 Prevalenca e dhimbjes së shpinës.....	xiv
3.0 Anatomia e zonës lumbare.....	xv
4.0 Fizpatologjia e dhimbjes së shpinës .....	xviii
5.0 Faktorët e rrezikut për dhimbjen e shpinës .....	xviii
6.0 Lloji i dhimbjes spinale sipas gjeneratorit të dhimbjes .....	xix
6.1 Dhimbja radikulare .....	xx
6.2 Sindroma e Fascetave artikulare.....	xxi
6.3 Dhimbjet e artikulacioneve sakroiliake .....	xxi
6.4 Stenoza e kanalit lumbar .....	xxii
6.5 Dhimbja diskogjenike .....	xxiii
7.0 Pasojat e dhimbjes lumbare.....	xxv
8.0 Diagnostikimi i lumbagos .....	xxvii
8.1 Radiografia .....	xxviii
8.2 Si diagnostikohet ?.....	xxviii
8.3 Imazhet Radiologjike .....	xxxi
8.4 Radiografia e thjeshtë .....	xxxi
8.5 Tomografia e kompjuterizuar (CT) .....	xxxi
8.6 Rezonanca Magnetike (MRI) .....	xxxii
II METODOLOGJIA .....	35
2.1 Qëllimi .....	35
2.2 Objektivat.....	35

2.3 Materiali dhe metoda .....	36
2.4 Metodologjia e analizës statistikore .....	37
III REZULTATE.....	38
IV DISKUTIM .....	52
V PERFUNDIME .....	64
VI REKOMANDIME .....	66
VII BIBLIOGRAFIA .....	67

### Lista e tabelave

Tabela 3. 1 Karakteristikat sociodemografike të pacientëve .....	38
Tabela 3. 2 Karakteristikat klinike të pacientëve .....	42
Tabela 3. 3 Faktorët e riskut për dhimbje-lumbago .....	45
Tabela 3. 4 Stili i jetesës dhe sëmundjet shoqëruese.....	47
Tabela 3. 5 Simptomat dhe frekuenca e dhimbjes .....	49
Tabela 3. 6 Lloji dhe frekuenca e gjetjeve imazherike.....	50
Tabela 3. 7 Lokalizimi i degjenerimit të diskut .....	51
Tabela 3. 8 Lokalizimi i degjenerimit të diskut sipas grupmoshës .....	52
Tabela 3. 9 Krahasimi i BMI me gjetjet imazherike .....	52
Tabela 3. 10 Shoqërimi i gjetjeve imazherike me dhimbjen. Regresioni logjistik. ....	54

### Lista e figurave

Figura 3. 1 Shpërndarja e pacientëve sipas gjinisë.....	39
Figura 3. 2 Histogrami i moshës së pacientëve.....	39
Figura 3. 3 Shpërndarja e pacientëve sipas grupmoshës .....	40
Figura 3. 4 Shpërndarja e pacientëve sipas BMI.....	40
Figura 3. 5 Korrelacioni i moshës me BMI .....	41
Figura 3. 6 Shpërndarja e pacientëve sipas statusit civil, nivelit arsimor, profesioni .....	41
Figura 3. 7 Tipi i dhimbjes.....	43
Figura 3. 8 Kohëzgjatja e dhimbjes.....	43
Figura 3. 9 Ashpërsia e dhimbjes .....	44
Figura 3. 10 Lokalizimi anatomik i dhimbjes .....	44
Figura 3. 11 Kufizimi i aktivitetit normal.....	45
Figura 3. 12 Mungesë në punë.....	45
Figura 3. 13 Faktorët e riskut për dhimbje .....	46
Figura 3. 14 Stili i jetesës dhe sëmundjet shoqëruese .....	48
Figura 3. 15 Simptomat dhe frekuenca e dhimbjes .....	49
Figura 3. 16 Gjetjet imazherike.....	50
Figura 3. 17 Lokalizimi i degjenerimit të diskut në vertebrat lumbare .....	51
Figura 3. 18 Lokalizimi i degjenerimit të diskut sipas grupmoshës .....	52
Figura 3. 19 Krahasimi i BMI me gjetjet imazherike, (nr. raste).....	53
Figura 3. 20 Shoqërimi i gjetjeve imazherike me dhimbjen. Regresioni logjistik.....	55



## Abstrakt

**Hyrje:** Dhimbja e mesit (lumbago) është ankesa më e zakonshme muskuloskeletike që prek popullatën adulte, me një prevalencë deri në 84%.

**Qëllimi i studimit** është të përshkruajë karakteristikat, gjetjet imazherike dhe diagnozën specifike klinike, në pacientët me lumbago.

**Materiali dhe metodat:** Ky është një studim prospektiv i kryer në repartin e Urgjencës së Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza” gjatë periudhës 2010-2014 dhe përfshin 247 pacientë me lumbago. Për të gjithë pacientët u mbodhen të dhënat sociodemografike, klinike dhe imazherike.

**Rezulate:** 95 (38.5%) janë femra dhe 152 (61.5%) janë meshkuj ( $p < 0.01$ ). Moshë mesatare e pacientëve është 41.2 (13.1) vjeç me rang nga 18 vjeç deri në 76 vjeç. Mbizotëron grupmosha 51-60 vjeç me 31.6% të totalit të pacientëve, me ndryshim sinjifikant me grupmoshat e tjera, ( $p < 0.01$ ). Mbizotëron dhimbja akute (76.1%) ndjekur nga dhimbja subakute (16.2%) dhe kronike (8.1%) ( $p < 0.01$ ).

Mbizotëron dhimbje në regionin lumbar (49%), ndjekur nga dhimbje lumbare dhe spinale (38%), dhimbje lumbare dhe koksofemorale (8%) dhe dhimbje lumbare dhe sakroiliake (5%), ( $p < 0.01$ ). Gjetjet imazherike ishin normale në 13% të pacientëve. Nga gjetjet patologjike mbizotërojnë: degjenerim diskal 71%, hernie diskale 63%, spondiloze 58%, stenozë e kanalit spinal 21%, discit 15%, zonë me intensitet të lartë 14%, kompresion i kordes/nervave 13%, ngushtim i foramina intervertebrale 13%, Spondilolistezë 6, metastazë 4%. Degjenerimi i diskut mbizotëron në L4/L5 (52.6%), ndjekur nga L5/S1 (24%). ( $p < 0.01$ ). Me pak të prekura janë L1/L2 (2.9%), L2/L3 (9.1%), L3/L4 (11.4%). Gjetjet imazherike mbizotërojnë tek pacientët me mbipeshë dhe obezë, me ndryshim sinjifikant me pacientët me BMI normale, ( $p < 0.05$ ).

**Konkluzion:** Lumbago duhet të trajtohet gjithmonë si një sëmundje komplekse në të cilën është e detyrueshme që të përcaktohet një diagnozë e saktë e gjeneratorëve të dhimbjes para fillimit të çdo trajtimi. Evidencat aktuale sugjerojnë që stërvitja vetëm ose në kombinim me edukimin është efektive për parandalimin e Lumbagos.

**Fjalë kyç:** lumbago, faktorë risku, imazheri

## I HYRJE

Dhimbja e mesit (lumbago) është ankesa më e zakonshme muskuloskeletike që prek popullatën adulte, me një prevalencë deri në 84%. Lumbago kronike (CLBP) është një sindrom i dhimbjes kronike në regjionin e poshtëm lumbar, që zgjat më shumë se 12 javë. Mjaft autorë sugjerojnë që dhimbja kronike të përcaktohet si dhimbje që zgjat përtej kohës së parashikuar të shërimit, duke e shmangur kriterin e saktë kohor. Ky përkufizim është mjaft i rëndësishëm, pasi thekson konceptin që CLBP ka shkaqe patologjike të mirëpërcaktuara dhe është një sëmundje, jo një simptomë. Lumbago kronike përfaqëson shkakun kryesor të aftësisë së kufizuar në të gjithë botën dhe është një problem madhor i mirëqënies dhe ekonomisë (1). Duke marrë parasysh këtë kompleksitet, vlerësimi diagnostik i lumbagos mund të jetë sfidues dhe kërkon vendimmarrje klinike komplekse. Duke iu përgjigjur pyetjes: Çfarë e gjeneron këtë dhimbje? Ndër të gjitha strukturat potencialisht të përfshira në CLBP, është faktori kyç në menaxhimin e këtyre pacientëve, pasi diagnoza e pabazuar në gjeneratorin specifik të dhimbjes mund të çojë në gabime terapeutike.



Figura 1. Lumbago akute

## 1.1 Përkufizimet e dhimbjes së shpinës

Dhimbja e mesit është e zakonshme dhe termi lumbago (LBP) është termi i zakonshëm shkencor për këtë sëmundje. Dhimbja e mesit, sindroma e shpinës si dhe dhimbja e shpinës përdoren gjithashtu por më rrallë. Megjithëse disa autorë përdorin termin dëmtim i mesit në mjediset e punës, dhimbja më e madhe ka të ngjarë të jetë me origjinë jo-traumatike edhe në këtë term, dhe dëmtimi i mesit mund të konsiderohet si sinonim i lumbagos (2). Grupi më i madh i pacientëve të prekur nga lumbago kanë të ashtuquajturën LBP jospecifik. Jo-specifike përdoret në kuptimin që dhimbja nuk është ose nuk mund t'i atribuohet një strukture specifike anatomike ose mekanizmit fiziologjik. Lumbago e thjeshtë dhe lumbago mekanike janë përdorur për të përshkruar të njëjtin grup pacientësh. Në studimet e popullatës termi 'dhimbje shpine' shpesh përdoret në vend të lumbagos. Ajo përfshin një pjesë më të madhe të shpinës dhe dallohet lehtë nga dhimbja e qafës, ndërsa ndryshimi nga lumbago është më pak i qartë. Mënyra më e lehtë për të përcaktuar zonën që përshkruhet është të përdorni një fotografi me zonën e shënuar. Përkufizimet e zakonshme të lumbagos përdorin një kufi të sipërm në skajin e poshtëm të shpatullës ose brinjën e fundit dhe një kufi të poshtëm në regjionin gluteal. Dhimbja që irradohet në këmbë ose lokalizohet ekskluzivisht nën kolonën lumbare përfshihet gjithashtu në konceptin e dhimbjes së shpinës. Kjo është e lehtë për t'u përcaktuar në ishiatik, në kuptimin e sindromave të galgioneve nervore të shkaktuara kryesisht nga disqet e hernuar. Megjithatë, dhimbja e irraduar është më e zakonshme se sindromat e komprimit të nervave dhe dhimbja që irradohet vetëm në kofshë shpesh përcaktohet si dhimbje shpine pa irradim. Dhimbja akute e shpinës zakonisht përcaktohet si kohëzgjatje më pak se gjashtë javë dhe dhimbja kronike e shpinës si kohëzgjatja më shumë se tre muaj. Termi dhimbje subakute shpesh përdoret për intervalin e ndërmjetëm (3). Dhimbja e shpinës me një dekurs të përsëritur është e vështirë të futet në këto përkufizime.

## 1.2 Historia e dhimbjes lumbare

Historia natyrore e lumbagos është studiuar gjerësisht, por ende citohet si e panjohur plotësisht, kryesisht për shkak të natyrës së saj heterogjene. Për shembull, sipas pikëpamjes aktuale, pjesa më e madhe e episodeve të dhimbjes së shpinës kanë kohëzgjatje të shkurtër, me kthim në punë brenda disa ditësh ose javësh, ku shkalla e ulët të dhimbjes dhe paaftësisë vazhdojnë më gjatë. Në disa aspekte në kundërshtim me këtë pikëpamje, dhe më pak e njohur nga mjekët e kujdesit shëndetësor parësor, lumbago zakonisht ka një dekurs përsëritës. Në një përmbledhje të lumbagos akute u zbulua se shumica e pacientëve kishin të paktën një rekurencë brenda një viti dhe megjithëse shumica e njerëzve kthehen në punë brenda një muaji, shumë prej tyre kanë dhimbje dhe paaftësi të mbetur (4). Për më tepër, një pjesë e konsiderueshme e subjekteve me dhimbje shpine zhvillojnë probleme afatgjata të shpinës (5). Individët që kanë dhimbje shpine me

dhimbje irradiuese, shiatike, ka të ngjarë të kenë simptoma më të zgjatura sesa ata pa irradim të dhimbjes. Ata gjithashtu mund të kenë një prognozë tjetër (5).

### 1.3 Tendencat laike në dhimbjen e shpinës

Është pohuar se nuk ka asnjë arsye për të dyshuar ndryshime në prevalencën e dhimbjes së shpinës vitet e fundit. Nga ana tjetër, literatura shkencore është e mbushur me pretendime për një epidemi në rritje të dhimbjes së shpinës. Ndërsa ka pasur një rritje të qartë të aftësisë së kufizuar të rimbursuar për dhimbjen e shpinës, nuk është e qartë nëse prevalenca e dhimbjes së shpinës në vetvete, domethënë simptoma e dhimbjes së shpinës, ka ndryshuar në dekadat e fundit (6).

Studimet e mëparshme tregojnë rezultate kontradiktore në lidhje me tendencat laike në dhimbjet e raportuara të shpinës. Në studimet britanike u zbulua një prevalencë e shtuar, ndërsa në studimet finlandeze dhe gjermane nuk u raportua ndonjë ndryshim apo edhe ulje e prevalencës së dhimbjes së shpinës me kalimin e kohës. Përveç kësaj, ka botime në të cilat janë përmbledhur rezultatet e studimeve të ndryshme dhe janë nxjerrë përfundime mbi tendencat e mundshme laike (7). Pas këtyre studimeve, u diskutua rëndësia dhe shkaqet e mundshme për prirjet laike. Provat për një epidemi të lumbagos në Mbretërinë e Bashkuar mbështeten në rritjen e pagesave të sigurimeve shoqërore që nga vitet 1950 dhe rritjen e konsultimeve nga mjekët e përgjithshëm gjatë së njëjtës periudhë. Me supozimin se shfaqja aktuale e dhimbjes së shpinës nuk ka ndryshuar ndjeshëm, diskutimi u përqëndrua në shkaqet e mundshme të ndryshimit gjatë raportimit. Ndryshimet në modelin e sëmundshmërisë muskuloskeletike në praktikën e përgjithshme dhe ndryshimet dramatike në shkallën e konsultimeve midis grupeve të ndryshme etnike në Mbretërinë e Bashkuar u panë si tregues të efekteve nga faktorët kulturorë (8).

Një tjetër shkak i mundshëm i raportimit të shtuar të dhimbjeve të shpinës mund të jetë fokusi në këtë nozologji dytësore për shkak të rritjes së paaftësisë së punës për shkak të dhimbjeve jo specifike. Disponueshmëria e shtuar e kujdesit shëndetësor mund të ketë kontribuar dhe në vetvete mund të ketë shkaktuar ndryshime të qëndrimit. Termi lumbago jo-specifike përcjell pak më shumë informacion sesa simptoma e raportuar e dhimbjes së shpinës. Prandaj koncepti i lumbagos jo-specifike si një diagnozë e pranuar, gjithashtu mund ta bëjë dhimbjen e shpinës më të ndjeshme ndaj ndryshimeve në raportim sesa diagnozat objektivist më të identifikueshme. Nga ana tjetër, ndryshimet në prevalencën e faktorëve të rrezikut mund të kenë nxitur rritjen e aftësive të kufizuara në punë që nuk ndërmjetësohen nga ndryshimet qëndrimit. Shembuj të faktorëve të tillë janë puna monotone sedentare, pakënaqësia me vendin e punës dhe ulja e niveleve të ushtrimeve fizike (9). Sidoqoftë, ndryshime të tilla mund të kompensoheshin nga ulja e faktorëve të tjerë të rrezikut, siç është puna e rëndë manuale. Vetëm ndryshimet në faktorët e rrezikut janë konsideruar si një shkak i pamundur i rritjes, duke pasur parasysh madhësinë, shpejtësinë dhe qëndrueshmërinë e ndryshimit në të gjitha grupmoshat e gjetura (10).

Pasojat e këtyre tendencave varen nga vëmendja që i kushtohet simptomës së dhimbjes së shpinës. Duke aplikuar modelin biomjekësor, nëse një rritje në raportimin e dhimbjes së shpinës ndiqet nga konsultime më të shpeshta me mjekët, mund të ketë një rrezik në rritje të ndërhyrjeve të papërshtatshme mjekësore, pasi dhimbja e shpinës konsiderohet si një simptomë e sëmundjeve të shpinës. Një shembull është përdorimi i imazherisë diagnostike, që në mënyrë të përsëritur është treguar të jetë më i lartë se rekomandimet në udhërrëfyesit e trajtimit (11). Rreziqetë ngjashme mund të vijnë nga modelet e tjera të kujdesit shëndetësor.

## 2.0 Epidemiologjia e lumbagos

LBP përfaqëson një problem të madh social dhe ekonomik. Prevalenca e lumbagos kronike vlerësohet të shkojë nga 15 në 45% në punonjësit e kujdesit shëndetësor francez (12); prevalenca e lumbagos kronike në të rriturit amerikanë të moshës 20-69 vjeç ishte 13.1%. Prevalenca e përgjithshme e lumbagos kronike në popullsi vlerësohet të jetë 5.91% në Itali. Prevalenca e lumbagos akute dhe kronike në të rriturit u dyfishua në dekadën e fundit dhe vazhdon të rritet në mënyrë dramatike në popullsinë në plakje, duke prekur si burrat ashtu edhe gratë në të gjitha grupet etnike 6. Lumbago ka një ndikim të rëndësishëm në kapacitetin funksional, pasi dhimbja kufizon aktivitetet profesionale dhe është një shkak kryesor i mungesave në punë 7–9. Barra e saj ekonomike përfaqësohet drejtpërdrejt nga kostot e larta të shpenzimeve të kujdesit shëndetësor dhe indirekt nga ulja e produktivitetit. Këto kosto pritet të rriten edhe më shumë në vitet e ardhshme. Sipas një rishikimi të vitit 2006, kostot totale të lidhura me lumbago në Shtetet e Bashkuara tejkalojnë 100 miliardë dollarë në vit, dy të tretat e të cilave janë rezultat i humbjes së pagave dhe uljes së produktivitetit (13).

Duke kërkuar për gjeneratorin e dhimbjes simptomat e lumbagos mund të rrjedhin nga shumë burime anatomike të mundshme, të tilla si rrënjët nervore, muskujt, strukturat fasciale, kockat, artikulacionet, disqet intervertebrale (IVD) dhe organe intraabdominale. Për më tepër, simptomat mund të lindin nga një dhimbje neurologjike në proces duke shkaktuar lumbago neuropatike. Vlerësimi diagnostik i pacientëve me lumbago mund të jetë shumë sfidues dhe kërkon vendimmarrje klinike komplekse. Sidoqoftë, identifikimi i burimit të dhimbjes është i një rëndësie themelore në përcaktimin e qasjes terapeutike<sup>13</sup>. Për më tepër, gjatë vlerësimit klinik, një klinikist duhet të marrë parasysh që lumbago gjithashtu mund të ndikohet nga faktorë psikologjikë, të tillë si stresi, depresioni dhe/ose ankthi (14,15). Historia gjithashtu duhet të përfshijë ekspozimin ndaj përdorimit të substancave, anamneza e detajuar, punën, zakonet dhe faktorët psikosociale (16). Informacioni klinik është elementi kryesor që nxit impaktin fillestar, ndërsa imazhet e rezonancës magnetike (MRI) duhet të merren parasysh vetëm në prani të elementeve klinike që nuk janë plotësisht të qartë ose në prani të deficiteve neurologjike ose situatave të tjera mjekësore (17). Rekomandimi i Kolegjit Amerikan të Radiologjisë është të mos

bëhet ekzaminim imazherik për lumbago brenda 6 javëve të para nëse nuk janë të pranishme shenjat alarmante. Ato përfshijnë trauma të rëndësishme të kohëve të fundit ose trauma më të buta tek individë mbi 50 vjeç, humbje në peshë ose ethe pa shkak të njohur, imunosupresion, sëmundje malinje e diagnostikuar më parë, përdorim i drogave intravenoze, përdorimi i vazhdueshëm i kortikosteroideve ose osteoporozë, mosha mbi 70 vjeç, dhe deficitet fokal neurologjike me simptoma progresive ose invalidizuese (18-20). Gjetjet imazherike nuk janë të lidhura ngushtë me simptomat. Në një studim ndër - sektorial të personave asimptomatikë të moshës mbi 60 vjeç, 36% kishin hernie diskale, 21% kishin stenoze spinale dhe më shumë se 90% kishin një disk të degjeneruar ose të fryrë (21).

Megjithëse nuk është e mundur të vlerësohet me saktësi, duhet të besohet se këto gjendje mund të kenë një kosto vjetore, drejtpërdrejt dhe tërthorazi, prej më shumë se 50 miliardë dollarësh dhe me sa duket deri në 100 miliardë dollarë (22). Një studim i kohëve të fundit vlerësoi se radiografia lumbare ishte realizuar 66 milion herë në Shtetet e Bashkuara në 2004, me një kosto prej 54 dollarë për çdo ekzaminim (23). Edhe pse vlerësimet ndryshojnë shumë në varësi të vendndodhjes gjeografike, statusit të sigurimit dhe faktorëve të tjerë, kostot e MRI duket të jenë 10 deri në 15 herë më të larta (23,24).

Udhëzimet më të fundit për mjekët sugjerojnë që kur përballen me pacientët me lumbago, klinikistët duhet të bëjnë një diagnozë të kujdesshme të mekanizmave që justifikojnë dhimbjen akute dhe/ose kronike. Trajtimi duhet t'i drejtohet veçanërisht këtyre mekanizmave. Në këtë mënyrë, ne mund të shmangim gabimin e zakonshëm në diagnozën e "lumbagos së thjeshtë", që mund të rezultojë në trajtim jo adekuat të një përkufizimi dhe jo një sëmundje komplekse. Meqenëse lumbago kronike mund të ketë gjeneratorë të njëkohshëm të dhimbjes, është e nevojshme një diagnozë multidisiplinare dhe trajtim multimodal (25).

## 2.1 Prevalenca e dhimbjes së shpinës

Si pasojë e një dekursi fluktuant, me vështirësitë tradicionale të llogaritjes së incidencës, shpesh përdoren më shumë matjet e prevalencës sesa incidenca. Dhimbja, duke qenë një përvojë subjektive, zakonisht matet me vetë -raportim. Prevalenca ndikohet jo vetëm nga përvoja e dhimbjes në vetvete, por edhe nga tendenca për të raportuar simptomën. Kjo e bën më të vështirë për të vlerësuar nëse prevalenca e simptomave ka ndryshuar me kalimin e kohës, meqë të dy këta përbërës mund të ndryshojnë.

Studimet mbi prevalencën e dhimbjeve të shpinës janë të shumta dhe janë publikuar disa përmbledhje (25-27). Nivelet e prevalencës variojnë nga më pak se 10% në më shumë se 75%. Kjo gamë e gjerë mund t'i atribuohet ndryshimeve në kohëzgjatje, severitetit dhe lokalizimit anatomik të dhimbjes së shpinës të studiuar. Prevalenca prej një muaji deri në një vit zakonisht ka qenë nga 20% në 60% në studimet evropiane (25, 27).

Point Prevalenca, dmth dhimbja në këtë moment, është e pavarur nga paragjykimet e kujtesës, por reflekton në mënyrë joadekuate natyrën rekurrente të dhimbjes së shpinës. Matjet tremujore janë propozuar për shumicën e variablave gjatë ndjekjes së studimeve të grupit për lumbago (28). Janë demonstruar mospërputhje midis shënimeve në kujdesin parësor shëndetësor dhe vetë -raportimeve të pacientëve (29).

Një zbulim i zakonshëm në studimet e prevalencës së dhimbjeve të shpinës është një rritje nga adoleshenca, një kulm në moshën e mesme, dhe më pas një rënie (25, 30-32). Dhimbja e fortë e shpinës, nga ana tjetër, është treguar të rritet me moshën gjatë gjithë jetëgjatësisë (30).

Gratë zakonisht raportojnë simptoma të përgjithshme disi më shpesh sesa burrat. Kjo vlen edhe për dhimbjen e shpinës dhe simptomat e tjera të dhimbjes muskulo-skeletike (31).

### 3.0 Anatomia e zonës lumbare

Kolona lumbare përbëhet nga pesë vertebra (L1 – L5). Anatomia komplekse e kolonës lumbare është një kombinim i këtyre vertebrave të forta, të lidhura me kapsula të përbashkëta artikulare, ligamente, tendina dhe muskuj, me inervim të gjerë.




Figura 2. Pamje krosseksionale e kolonës vertebrale

Shpina është projektuar të jetë e fortë, pasi duhet të mbrojë palcën kurrizore dhe mbaresat e nervave spinale. Në të njëjtën kohë, është shumë fleksibël, duke siguruar lëvizshmëri në shumë plane të ndryshme. Lëvizshmëria e kolonës vertebrale sigurohet nga nyjet simfizale midis trupave vertebrale, me një disk intervertebral ndërmjet tyre. Fashetat artikulare janë të vendosura midis dhe pas vertebrave ngjitur, duke kontribuar në stabilitetin e shtyllës kurrizore. Ato gjenden në çdo nivel të shtyllës kurrizore dhe sigurojnë rreth 20% të stabilitetit torsional (rrotullues) në segmentet e qafës dhe të shpinës (32). Ligamentet ndihmojnë në stabilitetin e nyjeve gjatë pushimit dhe lëvizjes, duke parandaluar dëmtimin nga hiperextensioni dhe hiperfleksioni. Tre ligamentet kryesore janë ligamenti anterior gjatësor (ALL), ligamenti posterior gjatësor (PLL) dhe ligamentum flavum (LF). Kanali kufizohet nga trupat dhe disqet vertebrale përpara dhe nga lamina dhe LF në pjesën e pasme. Të dy, ALL dhe PLL shtrihen në të gjithë gjatësinë e shtyllës kurrizore, përkatësisht anteriorisht dhe posteriorisht. Lateralisht, nervat dhe vazat spinale dalin nga foramen intervertebrale. Nën secilën vertebër lumbare, ekziston forameni përkatës, nga i cili dalin rrënjët nervore spinale. Për shembull, foramina nervore L1 ndodhet pak më poshtë vertebrës L1, nga ku del rrënja nervore L1. Disqet intervertebrale janë të vendosura midisvertebrave. Ato janë struktura të komprimueshme në gjendje të shpërndajnë ngarkesën kompresive përmes presionit osmotik. Në diskun intervertebral, anulus fibrosus (AF), një strukturë unazore koncentrike me kolagjen lamellar të organizuar, rrethon bërthamën e brendshme të pasur me proteoglikane (NP). Disqet janë avaskulare në moshë madhore, përveç periferisë. Në lindje, disku njerëzor ka pak furnizim vaskular por këto enë tërhiqen shpejt, duke e lënë diskun me pak furnizim të drejtpërdrejtë me gjak tek i rrituri i shëndetshëm (33).




Figura 3. Struktura e diskut intervertebral



Prandaj, mbështetja metabolike e shumicës së disqeve intervertebrale varet nga kartilaget ngjitur me trupin vertebral. Një degë meningeale e nervit spinal, e njohur më mirë si nervi rekurrent sinuvertebral, inervon zonën përreth hapësirës së diskut (33). Kolona lumbare drejtohet nga katër grupe funksionale të muskujve, të ndarë në ekstensorë, flektorë, flektorë lateralë dhe rotatorë. Vertebrat lumbare vaskularizohen nga arteriet lumbare që kanë origjinën në aortë. Degët spinale të arterieve lumbare hyjnë në foramen intervertebrale në secilin nivel, duke u ndarë në degë më të vogla anteriore dhe posteriore. Drenazhi venoz shkon parallel me furnizimin arterial (34). Në mënyrë tipike, fundi i palcës kurrizore formon conus medullaris brenda kanalit lumbar në kufirin e poshtëm të vertebrës L2. Të gjitha rrënjët nervore lumbare spinale rrjedhin nga lidhja midis rrënjës dorsale ose posteriore (somatike senore) nga aspekti posterolateral i palcës kurrizore dhe rrënjës ventrale ose anterior (motor somatike) nga këndi anterolateral i palcës. Rrënjët më pas rrjedhin poshtë përmes kanalit spinal, duke u zhvilluar në kauda ekuina, para se të dalin si një çift i vetëm nervash spinale në foraminën e tyre intervertebrale përkatëse. Trupat qelizorë të fibrave nervore motore mund të gjenden në brirët ventrale ose anteriore të palcës kurrizore, ndërsa ato të fibrave nervore sensore janë në ganglionin e rrënjës dorsale (DRG) në çdo nivel. Një ose më shumë degë meningeale të përsëritura, të njohura si nerva sinuvertebrale, dalin nga nervat lumbare të shtyllës kurrizore. Nervi sinuvertebral, ose nervi i Luscka, është një degë rekurente e krijuar nga bashkimi i ramus gri communicans (GRC) me një degë të vogël që vjen nga skaji proksimal i ramusit primar paraprak të nervit spinal. Ky nerv i përzier polisegmentar hyn drejtpërdrejt në kanal kurrizor dhe lëshon degë anastomozuese ngjithëse dhe zbritëse që përbëhen nga fibra somatike dhe autonome për unazën posterolaterale, trupin vertebral posterior dhe periostiumin, dhe meningjet ventral (35,36). Nervat sinuvertebral lidhen me degë nga nivelet radikulare si mbi dhe nën pikën e hyrjes, përveç anës kontralaterale, që do të thotë se lokalizimi i dhimbjes nga përfshirja e këtyre nervave është sfidues. Gjithashtu, fasetat artikulare marrin inervim me dy nivele që përfshijnë përbërës somatike dhe autonome. Të parët përcjellin një dhimbje lokale të mirë përcaktuar, ndërsa aferentët autonomë transmetojnë dhimbjen e referuar.




Figura 4. Muskujt që ndikojnë në funksionin e kolonës vertebrale

#### **4.0 Fizpatologjia e dhimbjes së shpinës**

Dhimbja ndërmjetësohet nga nociceptorët, neuronet sensore periferike të specializuara që na paralajmërojnë për stimujt potencialisht dëmtues në lëkurë duke i shndërruar këto stimuj në sinjale elektrike që transmetohen në qendrat më të larta të trurit (37). Nociceptorët janë neurone primare pseudo-unipolare somatosensore me trupin e tyre neuronal të vendosur në DRG. Ato janë aksone të bifurkuara: dega periferike inervon lëkurën dhe degët qendrore sinapsohen në neuronet e rendit të dytë në bririn dorsal të palcës kurrizore 36. Neuronet e rendit të dytë projektohen në mesencefalun dhe talamus, të cilat nga ana e tyre lidhen me kortekset somatosensore dhe cingulat anterior në mënyrë që të drejtojnë tiparet sensore-diskriminuese dhe afektive-njohëse të dhimbjes, përkatësisht (38). Kornu dorsal spinal është vendi kryesor i integritit të informacionit somatosensor dhe është i përbërë nga disa popullata interneuronesh që formojnë rrugë frenuese zbritëse dhe lehtësuese, të afta të modulojnë transmetimin e sinjaleve nociceptive. Nëse stimuli i dëmshëm vazhdon, mund të ndodhin procese të sensibilizimit periferik dhe qendror, duke e kthyer dhimbjen nga akute në kronike. Sensibilizimi qendror karakterizohet nga rritja e ngacmueshmërisë së neuroneve brenda sistemit nervor qendror, në mënyrë që inputi normal të fillojë të prodhojë përgjigje anormale. Është përgjegjës për alodininë taktile, domethënë dhimbjen e shkaktuar nga pastrimi i lehtë i lëkurës dhe për përhapjen e hiperndjeshmërisë së dhimbjes përtej zonës së dëmtuar indore. Sensibilizimi qendror ndodh në një numër çrregullimesh kronike të dhimbjes, të tilla si çrregullimet temporomandibulare, lumbago, osteoartriti, fibromialgjia, dhimbje koke dhe epikondilagjia laterale (39). Megjithë njohuritë e përmirësuara të proceseve që çojnë në sensibilizimin qendror, është ende e vështirë të trajtohet (40,41). Sensibilizimi periferik dhe qendror kanë një rol kyç në kronicizimin e lumbagos. Në fakt, ndryshimet minimale në posturë mund të nxisin lehtësisht inflamacion afatgjatë në nyje, ligamente dhe muskuj të përfshirë në stabilitetin e kolonës lumbare, duke ndikuar në sensibilizimin periferik dhe qendror. Për më tepër, nyjet, disqet dhe kocka janë shumë të inervuara nga fibrat delta A, stimulimi i vazhdueshëm i të cilave mund të kontribuojë lehtësisht në sensibilizimin qendror.

#### **5.0 Faktorët e rrezikut për dhimbjen e shpinës**

Shumë studime kanë identifikuar dhe implikuar një mori karakteristikash dhe ekspozimesh si faktorë rreziku për lumbago (42). Këto përfshijnë faktorë sociodemografikë, individualë dhe profesionalë. Shpesh këta faktorë ndryshojnë nga botimi në botim dhe rishikimet sistematike kanë gjetur se shumë prej këtyre faktorëve u mungon mbështetja, për shkak të dëshmive kontradiktore (43). Faktorët e rrezikut me siguri do të ndryshojnë sipas llojeve të dhimbjeve të shpinës, sipas faktorëve gjeografikë, mjedisit të kujdesit shëndetësor, etj.

Faktorë të ndryshëm rreziku ndikojnë në shfaqjen e dhimbjes sesa në kronicizimin e simptomave. Për shembull, ndërsa testet e performancës fizike nuk i shtojnë ndjeshëm parashikimit të rezultatit, ato diskriminojnë midis subjekteve me dhimbje dhe grupit të kontrollit të shëndetshëm. Obeziteti dhe niveli i ulët arsimor nuk ndikojnë në shfaqjen e dhimbjes, por rrit rrezikun e persistencës tek ata që kanë dhimbje (44). Për më tepër, numri i madh i faktorëve që janë testuar ilustron pikëpamjet e shumta të dhimbjes së shpinës, si dhe ndryshimet në disponueshmërinë e të dhënave. Ndërlidhjet dhe marrëdhëniet ndërmjet faktorëve të riskut janë komplekse dhe zgjedhja e faktorëve të rrezikut mund të përcaktojë rezultatit e një hetimi.

Meqenëse shkaqet kryesore të dhimbjes së shpinës mbeten kryesisht të papërcaktuara, modifikimi i faktorit të rrezikut mund të mos çojë në një ulje të suksesshme të incidencës së dhimbjes së shpinës. Prandaj, në vend të përpjekjeve të tilla, udhërrëfyesit evropiane për parandalimin e lumbagos rekomandojnë që ndërhyrjet parandaluese të drejtohen drejt parandalimit të rekurencave, kërkimit të kujdesit shëndetësor, paaftësisë dhe humbjes së punës (45).

Ata zbuluan se qasjet më premtuese kishin për qëllim rritjen e aktivitetit fizik ose përfshinin komponentë edukues bio-psikosocialë. Sidoqoftë, përmasat e efekteve duket të jenë modeste (46).

## **6.0 Lloji i dhimbjes spinale sipas gjeneratorit të dhimbjes**

Përkundër punës së madhe të bërë nga Shoqata Ndërkombëtare për Studimin e Dhimbjes 41, mbetet një shkallë konfuzioni në komunitetin mjekësor në lidhje me përkufizimet e dhimbjes së shpinës, dhimbjes së referuar, dhimbjes radikulare dhe radikulopatisë. Sidoqoftë, është i nevojshëm një vlerësim i saktë diagnostikues për të indikuar trajtimin e duhur. Një diagnozë dhe terapi e pasaktë që nuk është e përshtatshme mund të lidhet me aftësinë e pamjaftueshme diagnostike të një mjeku jo të specializuar në këtë sindromë, që i atribuohet një analize klinike dhe / ose instrumentale të pamjaftueshme, ose një qasje terapeutike të drejtuar drejt kontrollit të simptomave (dhimbjes) dhe jo mekanizmeve të gjenerimit të dhimbjes. Kryesisht, lumbago konsiderohet të jetë jo specifike, dhe ideja e gabuar që shkaku i 80 deri në 90% të rasteve të lumbagos është i panjohur ka vazhduar për dekada të tëra (47). Tensioni dhe spazmat muskulare janë ndër arsyet më të zakonshme të lumbagos, për shembull, në pacientët me fibromialgji. Në raste të tjera, lumbago mund t'i atribuohet gjeneratorëve të ndryshëm të dhimbjes, me karakteristika specifike, të tilla si dhimbja radikulare, e fascetave artikulare, sakro-iliake, dhe diskogjene, si dhe stenoza spinale.

## 6.1 Dhimbja radikulare

Dhimbja radikulare është dhimbje e evokuar nga shkarkimet ektopike që burojnë nga një rrënjë dorsale e inflamuar ose e dëmtuar ose nga ganglioni i saj; në përgjithësi, dhimbja irradohet nga shpina dhe glutesi në këmbë në një shpërndarje dermatomale (48). Hernia diskale është shkaku më i zakonshëm, dhe inflamacioni i nervit të prekur dhe jo komprimimi i tij është procesi më i zakonshëm patofiziologjik. Dhimbja radikulare është dhimbja e irraduar përgjatë rrënjës nervore pa dëmtime neurologjike. Edhe pse është dhimbje nociceptive, ajo dallohet nga nocicepsioni i zakonshëm sepse në dhimbjen radikulare aksonet nuk stimulohen përgjatë rrugës së tyre ose në terminalet e tyre periferikë por nga perinevriumi (49). Dhimbja radikulare ndryshon nga radikulopatia në disa aspekte. Radikulopatia dëmton përcimin drejt një nervi spinal ose rrënjëve të tij. Dëmtimi i fibrave sensore shkakton mpirje (të shpërndara sipas dermatomit); megjithatë, bllokada e fibrave motore shkakton dobësi (miotomale). Blloku sensor ose motor mund të rezultojë në ulje të reflekseve 46. Megjithëse radikulopatia dhe dhimbja radikulare shpesh shoqërojnë njëra-tjetrën, radikulopatia është vërejtur në mungesë të dhimbjes dhe dhimbja radikulare mund të ndodhë në mungesë të radikulopatisë. Është e rëndësishme të nënvizohet se, në kundërshtim me besimin e popullatës, nuk është e mundur të bëhet dallimi midis niveleve të dhimbjes radikale të L4, L5 dhe S1 (50,51).

Në fakt, vetëm kur radikulopatia shihet së bashku me dhimbjen radikulare, mund të vlerësohen segmentet. Në raste të tilla, shpërndarja dermatomale e mpirjes tregon segmentin e origjinës dhe jo shpërndarjen e dhimbjes. Hernimi i diskut lumbar me radikulopati mund të diagnostikohet gjatë ekzaminimit klinik duke përdorur testimin manual të muskujve, ngritjen e këmbës në nivel supin, shenjën Lasègue dhe shenjën e kryqëzuar Lasègue. Nëse historia e pacientit dhe gjetjet e ekzaminimit fizik tregojnë hernim të diskut lumbar me radikulopati, testi më i përshtatshëm jo -invaziv për të konfirmuar këtë mund të jetë një MRI. Kjo është veçanërisht e rëndësishme nëse nevojitet të vazhdohet me një trajtim invaziv ose të përcaktohet më mirë dëmtimi neurologjik. Testi tjetër më i përshtatshëm për të vlerësuar praninë e hernies së diskut lumbar është tomografia e kompjuterizuar (CT) ose mielografia CT, e cila do të ishte e përshtatshme për ata individë që nuk mund të kenë një MRI sepse është kundërindikuar ose ata për të cilët MRI nuk është përfundimtare. Gjithashtu, diagnoza e komprimimit të rrënjës nervore mund të arrihet me studimet elektrodagnostike, megjithëse ato nuk janë në gjendje të bëjnë dallimin midis hernies së diskut lumbar dhe shkaqeve të tjera të komprimimit nervor. Fatkeqësisht, duhet të vëmë re dukje se radikulopatia mund të jetë e pranishme pa dhimbjen radikulare dhe anasjelltas. Për këto arsye, testet elektrodagnostike nuk rekomandohen si një qasje e linjës së parë, por vetëm si zgjedhje e dytë, në mënyrë që të përcaktohet nëse ekziston neuropati periferike konkomitante ose neuralgji ose për të ndjekur dëmtimin e nervit të lezionuar (52).

## 6.2 Sindroma e Fascetave artikulare

Artikulacionet lumbare zigapofizeale janë proceset artikulare posteriore të kolonës lumbare. Ato formohen nga procesi inferior i vertebrës së sipërme dhe procesi i sipërm artikular i vertebrës së poshtme (53). Ato furnizohen nga degët mediale të rami dorsale (MBN). Këto nyje kanë një sasi të madhe të mbaresave nervore të lira dhe të kapsuluara (54) që aktivizojnë aferentet nociceptive dhe që moduloohen gjithashtu nga fijet eferente simpatike (55). Dhimbja lumbare zygapofizeale ose "fashetet artikulare" është vlerësuar se përbën deri në 30% të rasteve të lumbagos kronike (56), me nocicepsion me origjinë në membranën synoviale, kërcin hialin, kockën ose kapsulën fibroze të fascetës artikulare (57). Diagnostikimi i kësaj sindrome shpesh është i vështirë dhe kërkon një vlerësim të kujdesshëm klinik dhe një analizë të saktë të ekzaminimeve radiologjike. Pacientët zakonisht ankohen për dhimbje mesi me ose pa referim somatik të këmbëve që përfundon deri mbi gju, shpesh irradohet në kofshë. Nuk ekziston asnjë model radikular. Dhimbja e mesit tenton të jetë jashtë qendrës dhe intensiteti i dhimbjes është më i lartë se dhimbja në këmbë; dhimbja rritet me hiperekstensionin, rotacionin, përkuljen anësore dhe ecjen në malore. Përkeqësohet kur zgjoheni nga shtrati ose përpiqeni të qëndroni në këmbë pas uljes së zgjatur. Së fundmi, pacientët shpesh ankohen për ngurtësim të shpinës, e cila zakonisht është më e dukshme në mëngjes (58,59). Jackson ishte në gjendje të lidhte shtatë tipare me dhimbjen e fashetave: mosha e vjetër, episodet e mëparshme të lumbagos, ecja normale, dhimbje maksimale gjatë ekstensionit lumbar, por jo tendencë përkeqësimi të dhimbjes me manovrën Valsalva, dhe mungesë dhimbje në këmbë ose spazma muskulare (59,60). Është e vështirë të diagnostikosh këtë sindromë duke përdorur radiologjinë pasi nuk ka gjetje patognomonike për të kërkuar (61). Me MRI, ne mund të gjejmë shenja jo specifike të artrozës, osteofiteve dhe hipertrofisë së ligamenteve flavae. Sidoqoftë, nëse duam të studiojmë më mirë problemet e artrozës, CT është metoda e preferuar imazherike, edhe pse duhet pasur në konsideratë ekspozimi ndaj rrezatimit (58). Një nga ekzaminimet më të rëndësishme sigurohet nga rrezet X, veçanërisht projeksionet dinamike, të cilat mund të tregojnë paqëndrueshmërinë e kolonës (listezën që mund të rritet me përkuljen dhe shtrirjen e kolonës lumbare) me një ngarkesë të qartë të këtyre artikulacioneve (60). Si përfundim, pavarësisht kontributit të neuroimazherisë, historia dhe ekzaminimi klinik mbeten hapat themelore në diagnostikimin e sindromës së fashetave artikulare.

## 6.3 Dhimbjet e artikulacioneve sakroiliake

Artikulacionet sakroiliake (SIJs) janë të dedikuara për të siguruar mbështetje të qëndrueshme, por fleksibël për pjesën e sipërme të trupit (62,63). SIJ -të janë të përfshirë në lëvizjen sakrale, e cila gjithashtu ndikon drejtpërdrejt në disqet dhe pothuajse me siguri në artikulacionet më të sipërme lumbare. Inervimi i tij ende nuk është i njohur

mirë, por është raportuar të jetë nga degët te rrenjet lumbopelvike ventral (64); megjithatë, kjo ende nuk është konfirmuar. Nga ana tjetër, disa autorë kanë raportuar inervimin e SIJ nga degët e vogla nga rrënjët posteriore (65,66). Në një studim të vitit 2012 nga Patel et al. (66) , autorët demonstrojnë se dhimbja në SIJ ishte lehtësuar me sukses duke përdorur neurotomini të rrënjës primare dorsale L5 dhe degëve laterale të rrënjës sakrale dorsale nga S1 në S3 (63). Prandaj, ka prova të mjaftueshme që kjo procedurë ka një vlerë të rëndësishme për vendosjen e diagnozës dhe prognozës. SIJ njihet si burim i dhimbjes në shumë pacientë që paraqiten me lumbago kronike (67,68). Mendohet se dhimbja mund të gjenerohet nga tensionimi i ligamenteve osetensioni kapsular, komprimimi i jashtëm ose forcat e prerjes, hiper ose hipo mobiliteti, mekanika e dëmtuar e artikulacioneve dhe disfunksioni i zinxhirit kinetik duke shkaktuar inflamacion (69). Burimet intra-artikulare të dhimbjes SIJ përfshijnë osteoartritin; burimet ekstraartikulare përfshijnë entezinë/ndrydhjen e ligamenteve dhe entesopatinë primare. Përveç kësaj, ligamentet, tendinet, ose lishjet e fascieve dhe dëmtime të tjera kumulative të indeve të buta që mund të ndodhin posteriorisht aspektit dorsal të SIJ mund të jenë një burim diskomforti. Në ekzaminimin fizik, është e rëndësishme të ekzaminoni lëvizjen e artikulacionit, për shembull me një test stresi, i cili konsiston në shtypjen në kreshtën iliake (pelvis) ose pjesën e sipërme të kofshës, e cila mund të riprodhojë dhimbjen e pacientit. Dhimbja e SIJ shpesh nën-diagnostikohet. Duhet të merret parasysh në çdo situatë ku pacienti ankohet për lumbago posturale që përkeqësohet në pozicion ulur dhe me ndryshime posturale. Për më tepër, është e mundur që dhimbja e SIJ shpesh lidhet në mënyrë rigorozë me sindromat e fascetave artikulare pasi të dy lidhen me problemet posturale. Së fundi, është e rëndësishme të merret parasysh se dhimbja në SIJ mund të jetë gjithashtu një shenjë e sëmundjes reumatizmale. Gjetjet e MRI të efuzionit dhe inflamacionit artikular (veçanërisht nëse janë bilaterale) mund të paralajmërojnë mjekun që të ketë në vëmendje këtë gjendje.

#### **6.4 Stenoza e kanalit lumbar**

Stenoza e kanalit lumbar (LSS) mund të jetë e lindur (70) ose e fituar (ose të dyja). Mund të përcaktohet nga indet inflamatorë post operatorë të shtyllës kurrizore ose, edhe në mungesë të operacionit të mëparshëm, nga hernia diskale, trashja e ligamenteve ose hipertrofia e proceseve artikulare (71). Shumica e rasteve të LSS janë degjenerative, të lidhura me ndryshimet në shtyllën kurrizore me plakjen (72). LSS përcaktohet nga një ngushtim progresiv i kanalit qendror spinal dhe receseve laterale dhe komprimimit pasues të strukturave neurovaskulare (73). Zakonisht, diametri i kanalit normal lumbar ndryshon nga 15 në 27 mm. Në mund ta përcaktojmë stenozen lumbarë si një diametër të kanalit lumbar më të vogël se 10 mm, edhe pse një stenozë me diametër 12 mm ose më pak në disa pacientë mund të jetë simptomatike. Lartësia normale e foramenit varion nga 20 në 23 mm, me treguesin e stenozës së mundshme si 15 mm ose më pak (74). LSS

degjenerative është indikacioni më i zakonshëm për kirurgjinë spinale tek njerëzit mbi 65 vjeç (73). Simptomat më të shpeshta të stenozës lumbare janë radikulopatia me klaudikacio neurologjike, dobësim motorik, parestezia dhe dëmtimi i nervave sensorë (75). Simptomat mund të kenë një shpërndarje të ndryshme në varësi të llojit të LSS. Nëse LSS është qendrore, mund të ketë përfshirje të zonës midis fascetave artikulare dhe dhimbja mund të jetë bilaterale me një shpërndarje jo-dermatomale. Në stenozën e recesit lateral simptomat zakonisht gjenden dermatomalisht sepse nervat specifike janë komprimuar, që i ngjajnë radikulopatisë unilaterale (76). Flektimi i trungut, ulja, përkulja ose shtrirja mund të lehtësojnë diskomfortin, ndërsa qëndrimi i zgjatur ose ekstensionin lumbar mund të përkeqësojnë dhimbjen. Ulja ose shtrirja bëhen më pak efektive në zbutjen e dhimbjes ndërsa gjendja përparon, dhe dhimbja në pushim ose vezika neurogjene mund të zhvillohet në raste të rënda (76,77). Dhimbja neurogjene me klaudikacio është simptoma klasike e LSS, e shkaktuar nga kongjestioni venoz dhe hipertensioni rreth rrënjëve nervore. Dhimbja përkeqësohet duke qëndruar në këmbë por lehtësohet me shtrirjen në shpinë krahasuar me pozicionin supin, ulur, ulur në bisht dhe ekstensionin lumbar (78,79). LSS përgjithësisht diagnostikohet bazuar në një kombinim të anamnezës, ekzaminimit fizik dhe imazherisë (75). Gjetjet më të dobishme nga anamneza janë mosha, irradimi i dhimbjes në këmbë që përkeqësohet nga ngritja në këmbë ose ecja, dhe mungesa e dhimbjes kur jeni ulur (80). Ecja dhe qëndrimi pas ecjes mund të zbulojë një "test të përkuljes" pozitiv (79,80), të kryer duke i kërkuar pacientit të ecë me shpejtësi. Ndërsa dhimbja intensifikohet, pacientët mund të ankohen për simptoma sensore të ndjekura nga simptoma motorike, dhe nëse marrin një qëndrim të përkulur, simptomat mund të përmirësohen (80). Nëse pacientët ulen në një karrige të përkulur përpara, ata mund të kenë të njëjtin lehtësim (81). Metoda e rekomanduar për konfirmimin e diagnozës së LSS është MRI, e cila lehtëson vlerësimin e kanalit kurrizor dhe marrëdhënien anatomike midis elementeve spinale dhe nervore (80). Dekursi natyror i LSS të patrajtuar është i paqartë. Udhëzimet klinike të Shoqërisë Amerikane të Shtyllës kurrizore (NASS) arritën në përfundimin se dekursi natyror është i favorshëm në një të tretën e deri në gjysmën e pacientëve me LSS (82) të formës klinike të lehtë- mesatare. Studime të tjera sugjerojnë se gjendja mund të përkeqësohet në disa pacientë dhe të përmirësohet në rreth një të tretën e të tjerëve, ku shumica e pacientëve mbeten në gjendje të pandryshuar deri në 8 vjet ndjekje (83-85).

## 6.5 Dhimbja diskogjenike

Degjenerimi i diskut (DD) është vlerësuar si burim i CLBP në 39% të rasteve (86). Simptomat e tij janë jospecifike, aksiale dhe pa irradim radikular dhe ato ndodhin në mungesë të deformimit ose paqëndrueshmërisë së kolonës. DD është shpesh një diagnozë përjashtuese midis llojeve të tjera të CLBP. Në aspektin patologjik, ajo karakterizohet

nga degradimi, brenda diskut, i matriksit të NP me çarje radiale dhe/ose koncentrike shoqëruese në AF (87).




Figura 5. Ndryshime degjenerative të vertebrave

